

DREJT CILËSISË GJUHËSORE TË LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE

Një hap në plotësimin e zbrazëtirave në zbatimin e
Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve

Tetor, 2018



European
Union
Kosovo

Mirënjohe

Anëtarët e Koalicionit dëshirojnë të falënderojnë të intervistuarit nga institucionet dhe organizatat e ndryshme për gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë dhe të japin informacione dhe të dhëna të paçmueshme për këtë raport.

OJQ-ja udhëheqëse për publikimin e Raportit

ECMI Kosova (www.ecmikosovo.org)

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare që merret me çështjet e minoriteteve në Kosovë, me qëllimin e përgjithshëm për të zhvilluar institucione përfaqësuese, përfshirëse dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, dhe që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, përkrah institucionalizimin e organeve qeveritare që kanë të bëjnë me komunitetet, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për të punuar me njëri-tjetrin në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.

**Rruga "Nëna Terezë" Nr. 20, Apt. 5,
10000 Prishtinë—Kosovë,
Tel. +383 (0) 38 224 473**

**Rruga "Kralja Petra" 183a
38220 Mitrovicë e Veriut—Kosovë,**

Koalicioni për të drejta të barabarta për të gjithë - ERAC

ERAC mbledh së bashku shtatë (7) OJQ që punojnë në fushën e sundimit të ligjit dhe të të drejtave themelore, të cilat punojnë së bashku me 19 OJQ, me fokus në ngritjen e një rrjeti të qëndrueshëm të OJQ-ve, që janë aktive në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave themelore të grupeve të rrezikuara dhe/ose të marginalizuara. Fokus i specifik i projektit janë këto grupe: komunitetet jo-shumicë, gratë, rinia, dhe komuniteti LGBT. Edhe pse punojnë apo shtrijnë veprimet e tyre në tema dhe çështje të ngjashme, këtyre OJQ-ve u mungon bashkëpunimi dhe shpesh përqendrimi i punës së tyre është i ndarë në bazë të grupeve të veçanta të synuara, me të cilat punojnë ato, apo i ndarë sipas rajoneve ku ato shtrijnë aktivitetet e tyre. Me krijimin e një bashkëpunimi strukturor në mes të OJQ-ve të përzgjedhura dhe me ofrimin e mundësive formale për mësim të vazhdueshëm, veprimi gjeneron shkëmbimin e njohurive dhe përvojës në mes të OJQ-ve (duke përfshirë përvojën në çështjet institucionale), për të forcuar kapacitetet e tyre për avokim me institucionet qendrore dhe komunale, dhe për të rritur dukshmërinë e tyre në terren.

Anëtarë të ERAC-ut janë organizatat si më poshtë:

- Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve në Kosovë –Organizatë lider e Koalicionit;
- Qendra për Zhvillimin e Grupeve Shoqërore– anëtare e Koalicionit;
- Qendra për Barazi dhe Liri të komunitetit LGBT në Kosovë (CEL) – anëtare e Koalicionit;
- Qendra Kosovare për Studime Gjinore - anëtare e Koalicionit;
- Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - anëtare e Koalicionit;
- Kosovo 2.0 – anëtare e Koalicionit;
- Qendrën për Ndihmë Juridike dhe Zhvillim Rajonal (CLARD) - anëtare e Koalicionit;

Klauzolë e përgjegjësisë

Ky publikim është botuar me asistencë të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e ECMI Kosovo dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

E drejta e autorit©

Koalicioni të drejta të barabarta për të gjithë (ERAC), tetor 2018. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, ruhet në një sistem të rikthimit ose të transmetohet në asnjë formë ose me çfarëdo mjeti, elektronik, mekanik, foto-kopjimi, regjistrimi ose ndryshe, pa lejen paraprake të ERAC-ut.



DREJT CILËSISË GJUHËSORE TË LEGJISLACIONIT TË KOSOVËS NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE

Një hap në plotësimin e zbrazëtirave në zbatimin e
Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve



European
Union
Kosovo

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE.....	7
STATUSI I BARABARTË I PËRKTHIMIT TË LEGJISLACIONIT NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE: NË MES TË TEORISË DHE PRAKTIKËS.....	9
NDIKIMI.....	17
RRUGA PËRPARA.....	19
REKOMANDIMET.....	21
REFERENCAT.....	25

SHKURTESAT

UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
ZKGJ	Zyra e Komisionerit për Gjuhët
ZPGZ	Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare
ECMI Kosova	Qendra Evropiane për Çështje të Minoriteteve Kosovë
ERAC	Koalicioni të drejtat e barabarta për të gjithë

Të drejtat gjuhësore janë thelbësore për mbrojtjen efektive dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe për të siguruar të drejta të barabarta për të gjithë. Si komponentë e rëndësishme në aspektin e identitetit individual dhe kolektiv, të drejtat gjuhësore cilësohen si të drejta të rëndësishme në nivelin global, duke e marrë parasysh pozicionin e tyre në instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Me qëllim që të zhduken efektet e modeleve të diskriminimit që kanë ndodhur me dekada duke u bazuar në konfliktet etnike në Kosovë, dhe të krijohet një shoqëri e qëndrueshme dhe demokratike, Kushtetuta e Kosovës dhe Ligji i vitit 2006 për Përdorimin e Gjuhëve kanë vendosur një kornizë të gjërë ligjore për garantimin e të drejtave të barabarta, ku çdo qeveri e ardhshme duhet të i respektojë. Duke pasur parasysh rëndësinë që gjuha luan në përcaktimin e identitetit të komuniteteve, rëndësinë e të drejtës për përdorimin e gjuhës si e drejtë themelore si dhe konfliktin etnik të gjuhës në historinë e rajonit, të drejtat gjuhësore janë shihet kryesore në këtë kornizë për të drejta të barabarta. Ligji për Përdorimin e Gjuhëve e definon Kosovën si një shoqëri shumëgjuhësore me kornizë ligjore të avancuar për mbrojtjen dhe promovimin e përdorimit të gjuhëve në Kosovë. Edhe pse ky Ligj u miratua në kohën e UNMIK-ut, edhe pas shpalljes së pavarësisë, është ende valid dhe i zbatueshëm.

Sipas legjisllacionit të Kosovës, gjuha shqipe dhe serbe kanë status të barabartë dhe janë gjuhët zyrtare që përdoren në nivelin lokal dhe qendrorë të institucioneve të Kosovës. Përveç të tjerave, kjo do të thotë që të gjitha institucionet e Kosovës duhet patjetër të i publikojmë aktet nënligjore në gjuhën shqipe dhe serbe dhe të dyja verzionet duhet të kenë autoritet të njëjtë.¹ Në vitet e fundit, një numër i studimeve të bëra nga Zyra e Komisionerit për Gjuhët, OSBE, organizatat jo-qeveritare dhe gazetatat në gjuhën serbe kanë theksuar që legjisllacioni i Kosovës i përkthyer në gjuhën serbe nuk është në nivel të kënaqshëm. Ky raport do të prezantoj të gjeturat e nxjerra nga hulumtimi, të cilat e kanë definuar madhësinë dhe ndikimin e problemit, dhe do të ndalet aty ku janë ndalur edhe studimet e deritanishme. Në fillim, ky raport do të ofrojë një përmbledhje të çështjes dhe do të listojë bazën mbi të cilën ndodhë që kualiteti i përkthimit të legjisllacionit në gjuhën serbe është në nivel të pabarabartë me atë në gjuhën shqipe, më pas nënvizon ndikimin e zbatimit jo të kënaqshëm të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve kur është fjala tek përkthimi i legjisllacionit, e në rast të veçantë në qasjen e të drejtave të barabarta, dhe në fund prezanton një numër të rekomandimeve të drejtuar tek institucionet qeveritare përgjegjëse për të eliminuar mospërputhjen e përkthimit të legjisllacionit në gjuhën shqipe dhe serbe.

¹ Ligji për përdorimin e gjuhëve (Nr. 02/L-37), artikulli 5 dhe 8.

Shumica e informacionit analitik në këtë raport është bazuar në hulumtimet dhe raportet e publikuara nga Qeveria e Kosovës, OSBE, ECMI Kosova, Platforma për Analiza dhe Hulumtime (një grup joformal i 15 OJQ-ve që veprojnë në Kosovën e Veriut), UNMIK, USAID dhe gazeta Vesti. Vesti është përzgjedhur si burim për shkak të studimeve të saja të rëndësishme të bëra mbi këtë temë (Petković, 2014; Petković, 2015). Këto studime ofrojnë gjetje analitike të cilat tregojnë zbatimin jo të kënaqshëm të të drejtave gjuhësore në Kosovë në përgjithësi dhe ofrojnë të dhëna të detajuara të cilat tregojnë që kualitetit i përkthimit të legjislacionit të Kosovës në gjuhën serbe është shumë i dobët. Ky raport do të plotësojë të dhënat e këtyre hulumtimeve në dy mënyra. Së pari, do të fokusohet në ndikimin e mospërputhjes së përkthimit midis gjuhës shqipe dhe serbe në kornizën e përpjekjeve të vazhdueshme për të përfshirë gjuhën serbe në sistemin Gjyqësor të Kosovës në përputhje me Marrëveshjen e Brukselit të ndërmjetësuar nga BE. Për këtë pjesë të analizës, është mbajtur një intervistë me Z. Milan Bigović, gjyqtar në Gjykatën e Apelit. Së dyti, ky raport ofron rekomandime konkrete për të trajtuar çështjen në pajtueshmëri me procedurat e hartimit dhe ndryshimit të legjislacionit. Për këtë pjesë të analizës, hulumtuesit e ECMI Kosovës në kuadër të "Koalicionit të drejtat e barabarta për të gjithë (ERAC)", u bazuan në informatat e vlefshme të marra nga Departamenti Ligjor i Zyrës së Kryeministrit dhe Komisioneri i Gjuhëve Z. Slaviša Mladenović. Me qëllim të vlerësimit të ndikimit politik të rekomandimeve, në fund, përfaqësuesit e ECMI Kosovës dhe ERAC-ut u konsultuan edhe me Kryetarin e Kuvendit, Z. Kadri Veseli.

Ky raport fokusohet veçanërisht në kualitetin e akteve nënligjore në gjuhën serbe, i cili shihet që mungon dhe rrjedhimisht, është në kundërshtim me karakterin shumëgjuhësor të Kosovës, i cili garanton përdorim të barabartë të gjuhëve të komuniteteve të tjera përveç Shqipëtarëve dhe Serbëve të Kosovës në të gjitha nivelet e Qeverisë. Statusi i gjuhës serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë nënkupton se çdo dokument zyrtar në Kosovë duhet të jetë i disponueshëm në gjuhën serbe dhe se ky verzion duhet të jetë po aq kualitativ sa ai i përkthyer në gjuhën shqipe. Prandaj, siç do të shpjegohet dhe argumentohet në këtë raport, çështja e cilësisë së dobët të përkthimit të legjislacionit në gjuhën serbe është çështje e disa duhet të adresohet dhe zgjidhet sa më shpejtë të jetë e mundur duke u fokusuar në aspektin ligjor dhe të drejtave të njeriut.

STATUSI I BARABARTË I PËRKTHIMIT TË LEGJISLACIONIT NË GJUHËN SHQIPE DHE SERBE: NË MES TË TEORISË DHE PRAKTIKËS

Gjuha përbën një element thelbësor të identitetit njerëzor në nivel individual dhe nivel të komunitetit. Është mjet përmes së cilës një person e shpreh vetën dhe përmes së cilës ai ose ajo bëhen pjesë e një komuniteti shoqëror. Në nivelin e grupit, gjuha është padyshim faktori më i rëndësishëm që përcakton komunitetet kombëtare. Gjithashtu, është mjet i cili siguron qasje tek të drejtat tjera. Si të tilla, të drejtat gjuhësore, pjesë themelore të të drejtave të përgjithshme të njeriut, janë të drejta në vetvete por janë edhe si mënyrë e qasjes në të drejtat tjera të garantuara. Të analizuara nga prespektiva e të drejtave themelore të njeriut, të drejtat gjuhësore mbrojnë dinjitetin dhe identitetin, mirëpo gjithashtu sigurojnë liri dhe barazi në lidhje me mosdiskriminimin. Të drejtat gjuhësore janë veçanërisht të rëndësishme për komunitetet pasi që zgjerojnë diversitetin, parandalojnë konfliktet dhe u sigurojnë komuniteteve qasje më të mirë në arsim, fuqizim më të madh të gruas, menaxhim më të mirë të pasurive dhe përmirësim të cilësisë së shërbimeve publike (Raporti Special i OKB-së për të Drejtat e Minoriteteve, 2017).

Gjuha ka qenë një problem afatgjatë në marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve në Kosovë. Mosrespektimi i përdorimit të gjuhës shqipe ka luajtur një rol të madh në rritjen e konflikteve në Jugosllavinë Socialiste. Shfuqizimi i të drejtave kombëtare të Shqiptarëve të Kosovës nga regjimi i Slobodan Milosoviqit në fillim të viteve 90, i cili u shoqërua me mbylljen e shkollave të gjuhës shqipe në Kosovë, përfundimisht çoi në krijimin e strukturave paralele gjatë viteve 1990, gjatë të cilave Shqiptarët e Kosovës arsimuan vetën dhe i ofruan vetës shërbime të tjera të përditshme, ndërsa Qeveria Jugosllave fuqizoi gjuhën serbe në administrimin e saj (Demaj & Vandenbroucke, 2016, Kostovicova, 2005). Pas luftës, rolet u ndryshuan pasi që shumica Shqiptare mori kontrollin më të madh mbi jetën publike dhe populli Serb u tërhoq nga sfera publike e Kosovës. Duke e marrë parasysh rolin e theksuar të gjuhës në konfliktin etnik në Kosovë, Bashkësia Ndërkombëtare ka bërë të pamundurën të fuqizojnë përdorimin e barabartë të gjuhës shqipe dhe serbe dhe kanë cilësuar që kjo është një shtyllë bazë për një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike pas luftës së viteve 1990 (Groß, 2015). Pas pavarësisë së saj, Kosova u pajtua plotësisht me parimin e përdorimit të barabartë të gjuhëve, si një shtyllë përbërëse e identitetit të saj si shtet shumë-gjuhësh. Duke mos qenë anëtare e Kombeve të Bashkuara dhe Këshillit të Evropës, Kushtetuta e Kosovës promovon vlerat e Kartës Evropiane për Gjuhët Rajonale ose të Minoriteteve dhe Konventën për Mbrojtjen e Pakicave

Kombëtare dhe përcakton se të drejtat e njeriut në Kosovë do të interpretohen në përputhje me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Kushtetuta e Kosovës dhe Ligji për Përdorimin e Gjuhëve cekin që “karakteri shumë gjuhësor i shoqërisë kosovare, paraqet vlerat e saj unike shpirtërore, intelektuale, historike dhe kulturore.”² Gjuha shqipe dhe serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare në Kosovë dhe kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës.³ Çdo person e ka të drejtën të komunikojë dhe të marrë shërbimet e nevojshme dhe të ketë qasje në dokumentet publike në cilëdo gjuhë zyrtare.⁴ Lirija e shprehjes është e garantuar dhe diskriminimi në bazë të gjuhës është i indaluar.⁵ Një nen i veçantë në Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve thekson që të gjitha ligjet, rregulloret dhe aktet nënligjore të miratuara në nivel lokal dhe qendrorë, duhet të nxirren dhe publikohen në gjuhët zyrtare.⁶

Megjithatë, zbatimi i kësaj të fundit mbetet ende i mangët. Disa pasaktësi flagrante në legjisllacionin e Kosovës të përkthyer në gjuhën serbe kanë marrë vëmendje të veçantë në disa studime të kryera nga një sërë akterësh siç janë: Zyra e Komisionerit për Gjuhët, Zyrën e Kryeministrit të Kosovës në bashkëpunim me OSBE-në; organizata jo-qeveritare; dhe gazeta lokale. Hulumtimi i bërë nga gazeta serbe Vesti ka gjetur rreth 4,500 gabime në një mostër të ligjeve të ndryshme të përkthyer nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe rreth 5,500 gabime në përkthimin në gjuhën serbe të Kodit Penal të Kosovës, duke përfshirë një gabim gramatikor në vetë titull (Petković, 2014; Petković, 2015). Këto gabime janë gabime të thjeshta gramatikore; gabime ku shihet një ndërthurje me fjalët në gjuhën boshnjake dhe kroate; gabime ku vërehet përdorimi i fjalëve joadekuate, lëshime të fragmenteve dhe formulime të pakuptimta.

Duhet të theksohet se jo të gjitha këto gabime janë verifikuar në mënyrë të pavarur nga ECMI Kosovo; megjithatë, kemi marrë disa shembuj specifik të cilët i kemi prezantuar më poshtë. Duke u bazuar në përkthime, mund të thuhet që ato janë bërë në mënyrë mekanike, pa u marrë në konsideratë konteksti më i gjërë ligjor apo specifikat në gjuhën serbe (OSBE, 2012, PAR, 2016). Cilësia e dobët e përkthimeve të dokumenteve zyrtare ligjore në gjuhën serbe shpesh konsiderohet si shembull i zbrazëtirave në mes të kornizës ligjore ambicioze të Kosovës për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe praktikës (PAR, 2016). Kur e shikojmë të njëjtin ligj, mund të vërejmë se ndryshon

² Ligji për përdorimin e gjuhëve (Nr. 02/L-37), Neni 1.1.iv.

³ Ligji për përdorimin e gjuhëve (Nr. 02/L-37), Neni 1.2.

⁴ Ligji për përdorimin e gjuhëve (Nr. 02/L-37), Nenet 4.2 & 7.2.

⁵ Ligji për përdorimin e gjuhëve (Nr. 02/L-37), Neni 3.1.

⁶ Ligji për përdorimin e gjuhëve (Nr. 02/L-37), Neni 5.4.

shumë në përkthimin në gjuhën shqipe dhe serbe, fakt ky i cili çon në dykuptimësi lidhur me domethënien aktuale të ligjit në fjalë. Rrjedhimisht, substanca apo përmbajtja e ligjit mund të jetë kundërshtueshme.

Mund të theksohet se kualiteti i dobët i përkthimit të legjislacionit në gjuhën serbe për disa vite tregon që ky është një problem institucional. Dështimi për të përmirësuar mospërputhjet e shumta në mes përkthimit në gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe të legjislacionit të Kosovës, tregon neglizhencën politike nga ana e Qeverisë së Kosovës që të ndajë kohë dhe mjete për të rregulluar këtë çështje. Megjithatë, siç do të bëhet e qartë më poshtë, kemi të bëjmë me disa ndryshime të cilat japin shenja se kjo çështje është marrë seriozisht nga Qeveria e tanishme.

Disa shembuj dhe sqarime të cilat janë prezantuar në raport, do të japin më shumë detaje mbi ndjeshmërinë dhe ndikimin e mundshëm të kësaj çështje. Neni 2.1 i Kushtetutës së Kosovës thotë (në versionin anglisht) "Sovraniteti i Kosovës buron nga populli, i takon popullit dhe ushtrohet, në pajtim me Kushtetutën, nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur, me referendum, si dhe në forma të tjera, në pajtim me dispozitat e kësaj Kushtetute." Në versionin e gjuhës shqipe, ky Nen është i njëjtë, kurse në versionin e gjuhës serbe, nuk është përfshirë fjala "referendum" fare. Mungesa e kësaj fjale në fjali, mund të thuhet të jetë nga përkthimin joprofesional. Duke e parë nga prespektiva e komunitetit Serb, këto gabime mund të cilësohen si gabime me motive jo të mira. Dr Darko Simović, një profesor i Ligjit Kushtetues nga komuniteti Serb, në hulumtimin e bërë nga gazeta Vesti thotë që një përkthim i tillë i kualitetit të dobët "është supozuar të fshehtë këtë mekanizëm i cili është në favor të shumicës" (Petković 2014). Kur është pyetur në lidhje me këtë fenomen Komisioneri për Gjuhët, Z. Slavica Mladenović, ka thënë që problemet janë të shumta dhe se cilësia e dobët e përkthimeve të ligjeve në gjuhën serbe është më shumë çështje e neglizhencës politike dhe mungesës së mjeteve. Megjithatë, mungesa e profesionalizmit dhe vëmendja ndaj detajeve në lidhje me përkthimin e legjislacionit mund të konsiderohet një paradigmë e vështirësive me të cilat përballet Qeveria e Kosovës në tërësi.

Sa i përket forcës së policisë, dokumentet e përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe, përmbajnë informata për dhënie të ndryshme të autorizimeve. Versioni në gjuhën shqipe, paragrafi 4.19 i Manualit të Procedurës së Policisë së Shërbimit Policor të Kosovës thotë se "përdorimi i prangave është një përdorim i forcës dhe duhet të arsyetohet me përdorimin e politikës së forcave të SHPK-së", ndërsa në versionin në gjuhën serbe, 9 njeiti paragraf thotë që "vetëm kur masa të tjera më të dobëta janë joefikase". Kërkesat e cekura në versionin në gjuhën shqipe

të cilat përmendin që akti duhet të justifikohet kundrejt versionit në gjuhën serbe ku thotë se opsionet e tjera duhet të harxhohen, krijon një zbrazëtim në siguri dhe kështu "pragu për përdorimin e forcës në versionin në gjuhën serbe duket të jetë më i ulët se në versionin në gjuhën shqipe." Kjo ka ndikim negativ të drejtpërdrejtë në të drejtat e individit "(OSBE 2012, f.23). Duke marrë parasysh efektet destabilizuese të përdorimit të forcës nga ana e policisë ndaj popullatës civile, veçanërisht në rastin e marrëdhënieve etnike problematike siç është rasti në Kosovë, çështja në fjalë u adresua dhe përmirësua duke i ndjekur syzjerimet e OSBE-së.

Neni 12 i Kodit Penal të Kosovës ka interpretime shumë të ndryshme të të njëjtit udhëzim. Versioni i përkthyer në gjuhën shqipe dhe angleze përdorin "refuzojnë sulmin", ndërsa verzioni në gjuhën serbe përdorë termin "shmang sulmin". Kjo ndryshon në masë të madhe të drejtën për vetëmbrojtje dhe dhunë në mes të dy (2) komuniteteve. Një masë mbrojtëse në verzionin e gjuhës shqipe mund të shihet si një veprim fytes në verzionin në gjuhën serbe, nëse udhëzimi interpretohet ndryshe nga zyrtari në fjalë. Njëjtë, edhe neni 13 ka një mospërputhje të madhe në mes të dy (2) verzioneve. Versioni i përkthyer në gjuhën serbe, thuhet që ... duhet të jetë më i vogël se ai që është kërcënuar, dhe në versionin origjinal [në gjuhën shqipe] thuhet ...nuk duhet të jetë më i madh (Petković, 2015). Ky ndryshim, gjithashtu ndryshon nivelin e dhunës së arsyetuar në vetëmbrojtje, gjë që mund të çojë në një zbatim të pabarabartë të kodit penal.

Mungesa e përkthimeve kualitative, mund të ketë gjithashtu implikime të rënda ligjore. Në një rast, Ligji për Procedurën Kontestimore është përdorur për të argumentuar kundër tij (të njëjtit Ligj) për shkak të gabimeve në përkthim në Nenin 258 (4). Kërkesa e bërë nga njëra palë u hodh poshtë në bazë të artikullit të versionit të përkthimit në gjuhën serbe. Përfaqësuesi ligjor i palës së dëmtuar, kundërshtoi këtë vendim, duke iu referuar të njëjtës dispozitë në versionin në gjuhën shqipe, i cili është i kundërt me versionin në gjuhën serbe, dhe lejon që të bëhet kërkesa në këtë rast (OSBE, 2012, f.26). Duke pasur parasysh që të dy gjuhët dhe përkthimet e tyre ligjore kanë status të njëjtë, kjo situatë krijon një konflikt të drejtpërdrejtë ndërmjet dy versioneve të të njëjtës dispozitë ligjore.

Në disa raste tjera, mungojnë paragrafe të tëra në verzionin në gjuhën serbe. Versioni në gjuhën shqipe i Doracakut të Policisë së Kosovës dhe Procedurave të 2007-ës ka një paragraf të plotë mbi politikën e mosdiskriminimit, e cila mungon komplet në versionin në gjuhën serbe (OSBE, 2012, f.24). Duke e marrë parasysh këtë mungesë në manualin në verzionin e gjuhës serbe, mund të

thuhet që disa udhëzime apo segmente të udhëzimeve të caktuara të forcës së policisë krijojnë mundësi të arsyetohen rastet e diskriminimit. Këto pasaktësi, gjithashtu, u përmirësuan pas publikimit të raportit të OSBE-së, mirëpo raste tjera të identifikuar të dallimeve në mes të dokumenteve të ndryshme të Qeverisë tregojnë se akoma ka nevojë për veprime të cilat kanë për qëllim luftimin dhe zhdukjen e kësaj dukurie.

* * *

Si mund të ndodhë që këto mospërputhje të mëdha shfaqen në versionin e përkthyer në gjuhën serbe të akteve ligjore të Kosovës? Problemi i parë qëndron në procesin e hartimit të ligjeve të bëra nga ekspertë që flasin veç një gjuhë. Për të garantuar cilësinë gjuhësore të akteve ligjore në rastet kur gjuhët e ndryshme janë njëllor autoritative siç në rastin e gjuhës shqipe dhe serbe, ligjet duhet të hartohen dhe diskutohen në të dy gjuhët njëkohësisht. Vetëm në këtë mënyrë mund të shihet nëse: ligji do të reflektojë në mënyrë linguistike pjesëmarrjen e komuniteteve të ndryshme në procesin e hartimit; do të adresojë mospërputhjet apo pasaktësitë gjuhësore gjatë procesit të hartimit; dhe do të shihet nëse koncepti i ligjit është saktësisht i përshkruar në të dyja gjuhët. Në institucionet në nivelin qendror të Kosovës, shumica e ligjeve hartohen dhe shkruhen në gjuhën shqipe. Secili institucion qeveritarë mund të propozojnë një ligj dhe Qeveria pastaj do të merr një vendim, që çon në formimin e një grupi punues.⁷ Një grup i tillë do të përbëhet nga Ministritë dhe Institucionet e ndryshme që do të preken nga përpilimi i një ligji të tillë.⁸ Në praktikë, për të mos thënë që nuk ekziston fare, pjesëmarrja e Ministrave dhe nëpunësve civil të komunitetit Serb në grupet punuese të formuara nga Qeveria, është shumë e vogël. Për arsye politike, partitë e komunitetit Serb shpesh refuzojnë të marrin pjesë në punën e Qeverisë së Kosovës dhe Kuvendit; ku si pasojë, mund të ceket që nëpunësit civil të komunitetit Serb mos të shprehin interesim dhe dëshirë të marrin pjesë në grupin punues me qëllim të përpilimit të ligjit përkatës. Rrjedhimisht, legjislacioni zakonisht përpilohet në gjuhën shqipe, dhe pasi të jetë i plotë, përkthehet edhe në gjuhën serbe. Ndryshimet në fazën e hartimit të ligjeve, veçanërisht në Grupin Ndërmnistror të Punës, shumë shpesh bëhen vetëm në gjuhën shqipe. Pas përfundimit të procesit të hartimit, ligjet përkthehen në gjuhën angleze dhe më pastaj në gjuhën serbe, kështu duke rritur shanset e mospërputhjeve dhe keqpërkthimeve (OSBE, 2018, f.10; Petković, 2015). Kjo praktikë krijon një pabarazi në cilësinë e dokumenteve zyrtare në të dyja gjuhët zyrtare, pasi që verzioni i ligjit specifik në gjuhën serbe gjithmonë përkthehet nga një dokument origjinal, apo edhe nga ligji përkatës i versionit të gjuhës angleze. Kështu që

⁷ Ligji për Nisma Legjislative (Nr.04/L-025), Neni 9.

⁸ Regullorja për Regullat dhe Proceurat e Qeverisë së Kosovës (Nr.09/2011).

cilësia gjuhësore e tekstit pasqyron pjesëmarrjen e limituar të pjesëtarëve të komunitetit Serb në procesin legjislativ, i cili rezulton të ketë cilësi të dobët të përkthimit të akteve legjislative në gjuhën serbe.

Një problem tjetër në procesin aktual është edhe mungesa e pjesëmarrjes së shoqërisë civile të komunitetit Serb në procesin e hartimit të legjislacionit të Kosovës. Rregullorja mbi Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik përcakton që të gjitha organet publike të Kosovës duhet të sigurojnë mundësi të barabarta dhe jodiskriminuese për pjesëmarrje të të gjitha palëve të interesuara dhe publikut në procesin e konsultimit publik.⁹ Për më tepër, në këto procese mungon edhe pjesëmarrja e përqafësuesve të shoqërisë civile apo qytetarëve që vijnë nga komuniteti shumicë. Nga 107 dokumente të miratuara nga Qeveria në vitin 2017, vetëm 36 u publikuan në Platformën Online për Konsultime Publike, e nga këto, vetëm gjashtë (6) janë komentuar nga palët e interesit të jashtëm (KCSF, 2018). Megjithatë, mos përkthimi në gjuhën serbe i ligjit në proces të hartimit, dhe përkthimi i tij vetëm pasi të bëhet drafti final, tregon që pjesëmarrës në këtë proces janë vetëm akterët që e flasin gjuhën shqipe. Kështu që, përveç që cilësia e përkthimit të legjislacionit në gjuhën serbe është e dobët, edhe procesi i përkthimit konsiderohet si proces që i përjashton përfqësuesit e komuniteteve dhe i dëmshëm për pjesëmarrjen e tyre në shoqërinë Kosovare.

Duke pasur parasysh që përkthimi i legjislacionit dhe të gjitha dokumenteve qeveritare është çështje problematike, pavarësisht sa i mirë mund të jetë përkthimi, një problem shtesë me të cilin ballafaqohet Kosova dhe Qeveria e saj, është mungesa e kapaciteteve financiare dhe burimeve njerëzore për përkthimin cilësor. Në nivelin komunal, njësitë e përkthimit në komuna përkatëse, shpesh nuk ekzistojnë dhe përkthimet jepen ose bëhen ad hoc nga stafi. Shpesh duket të jetë një mungesë e vetëdijes në lidhjen me nevojën e përkthimit të dokumenteve publike në të gjitha gjuhët zyrtare, veçanërisht në zonat të banuara me komunitete. Si rrjedhojë, një numër i konsiderueshëm i akteve legjislative nuk janë në dispozicion në gjuhën serbe (ZKGJ, 2015, OSBE, 2014). Në nivel qendror ekzistojnë njësi të përkthimit, por shpesh ballafaqohen me mungesën e personelit të kualifikuar, buxhetit dhe pajisjeve profesionale (për shembull: mungesa e mjeteve themelore si kompjuteri ose madje edhe fjalorët juridikë).¹⁰ Gjithashtu, Qeveria e Kosovës nuk ka ndonjë program të trajnimit të përkthyesve në kuadër të programit të gjërë të saj. Përkthyesit nuk paguhen mjaftueshëm, gjë që i shtyen ata të kërkojnë punë në sektorin privat (OSBE, 2018). Një rezultat i kësaj është që angazhimi i jashtëm për të përkthyer tek firmat/kompanitë private është më e zakonshme tani, edhe pse kjo garantohe

⁹ Rregullore për Standardet minimale për procesin e konsultimit public (Nr. 05/2016), Neni 4.1.1.

¹⁰ Intervista me Komisionerit për Gjuhët Slaviša Mladenović, tetor 2018.

gjithmonë me cilësi të njëjtë si përkthimet që bëhen brenda institucionit.¹¹

Përkthyesit shpesh nuk janë të specializuar apo njoftuar me terminologjinë legislative, pasi që ka mungesë të madhe të mundësive të arsimimit që ofrohen për të ngritur kapacitetet e tyre për të përkthyer dokumente ligjore në gjuhën shqipe dhe serbe në Kosovë (ZKGJ, 2015; OSBE 2018; PAR 2016). Ky problem bëhet edhe më i theksuar me integrimin e vazhdueshëm të gjyqësorit Serb në kornizën Gjyqësore të Kosovës.¹² Qeveria punëson përkthyes të kategorisë "Profesional 2" të katalogut të brendshëm të punësimit; megjithatë, nuk ka kërkesa specifike sa i përket niveleve të arsimimit për përkthyes të tillë. Për më tepër, të punësuarit nën këtë gradë paguhen nën nivelin e pagës relativisht të ulët 9 - me 1 pagën më të lartë dhe 14 më të ulët - që e vërteton edhe njëherë atë që u tha më lartë që tërheqja e përkthyesve me cilësi të mirë është relativisht e vështirë për këtë shkak.¹³ Përveç kësaj, Qeveria nuk ka ndonjë standart të përdorimit të terminologjisë ligjore, gjë që krijon mospërputhje të përkthimeve nga njëra gjuhë në tjetrën. Në Zvicër, për shembull, një fjalor trilingual përcakton se cili term ligjor do të përdoret dhe cilat janë ekuivalentët e saj në gjuhët e tjera zyrtare. Një praktikë e tillë nuk ekziston në Kosovë, që do të thotë se edhe brenda një Ministrie, për të njëjtin concept, përodren terme të ndryshme.

Përveç mungesës së fondeve, procesi i përkthimit brenda Qeverisë është gjithashtu i dobët nga mungesa e procedurave për përkthim të dokumenteve legislative. Punësimi i stafit, shpesh, është çështje problematike, ku shpesh nuk bëhet dallimin në mes të "përkthyesit" dhe "interpretuesit" në disa institucione qeveritare.¹⁴ Shpesh, organet shtetërore e përdorin termin e përcaktuar nga ta i cili është "gjuhësor", pasi që ka mungesë të vetëdijës së funksionit të kësaj pozite edhe nga anëtarët e komisioneve që përcaktohet të intervistojnë kandidatët.¹⁵ Këto probleme janë rritur me faktin që nuk ekziston ndonjë proces zyrtar i certifikimit, që do të thotë që kompetencat e punonjësve të ardhshëm janë jashtëzakonisht të vështira për të u vlerësuar. Një problem ngjashëm, i cili veçanërisht ka të bëjë me cilësinë e ulët të përkthimeve në gjuhën serbe, është numri i ulët i përkthyesve që flasin gjuhën serbe si gjuhë të tyre amtare (OSBE 2018). Ndoshta gjuha amtare e një përkthyesi nuk duhet të ndikojë në cilësinë e përkthimit, por, ky fakt në kombinim me mundësinë e limituar edukativo-arsimore të përkthyesve të dokumenteve legislative, bën që në Kosovë kemi një kualitet shumë të dobët të përkthimit të legjislacionit në gjuhën serbe.

¹¹ Intervista me Komisionerit për Gjuhët Slaviša Mladenović, korrik 2018.

¹² Intervista me Gjykatësin Milan Bigović, Shef i Departamentin në Gjykatën e Apelit, korrik 2018.

¹³ Ministria e Administratës Publike, Katalogu i Vendeve të punës në Shërbimin Civil të Kosovës.

¹⁴ Intervista me Komisionerit për Gjuhët Slaviša Mladenović, tetor 2018.

¹⁵ Intervista me Komisionerit për Gjuhët Slaviša Mladenović, tetor 2018.

Aftësitë dhe kualifikimet e përkthyesve në mes të gjuhës serbe, shqipe dhe angleze janë gjithashtu në nivel të dobët. Legjislacioni fillimisht përpilohet në gjuhën angleze, praktikë kjo e bërë gjatë kohës së UNMIK-ut, e cila po vazhdon edhe sot. Shumë përkthyes në gjuhën aërbe e përdorin verzionin final të gjuhës angleze. Për më tepër, shumë nga traktatet e të drejtat themelore të njeirut dhe marrëveshjet ndërkombëtare janë të shkruara në gjuhën angleze, si gjuhë e parë, që do të thotë që ekziston shqetësim jo vetëm për kualitetin e përkthimeve në gjuhën serbe por edhe në gjuhën shqipe nga gjuha angleze. Përkthimet e gabueshme në gjuhën serbe të traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare nuk do të mund të adresohen plotësisht nëse edhe përkthimi nga gjuha angleze në gjuhën shqipe është gabim.¹⁶

¹⁶ Intervista me Komisionerit për Gjuhët Slaviša Mladenović, korrik 2018.

Mospërputhja në përkthime e legjislacionit të Kosovës në gjuhën shqipe dhe gjuhën serbe ka ndikim të madhë dhe substancial. Nga prespektiva ligjore, mospërputhjet nuk e shkelin Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve në Kosovë. Në nivel qendror posaqërisht, aktet ligjore janë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe në përputhje me ligjin (ZKGJ, 2015, f.71). Megjithatë, cilësia e dobët e përkthimeve të ligjeve të Kosovës në verzionin e gjuhës serbe shkakton pasoja të mëdha. Siç është shpjeguar në shembujt më lartë, ky faktor mund të shkaktojë edhe implikime ligjore në rastet kur përkthimet e gabuara krijojnë mospërputhje midis verzioneve të ligjit relevant në gjuhën shqipe dhe serbe.¹⁷ Në ato raste, “mund të ndodhë të i kemi dy versione të ligjit, të dyja me vlerë të njëjtë, me dy kuptime të ndryshme, me pasoja potenciale të mëdha.” (Burema & Najvirtova, 2014, f. 14) Në përpjekje të vazhdueshme për integrimin e gjyqtarëve të komunitetit Serb, pjesëtarëve të komunitetit Serb dhe komuniteteve tjera që flasin gjuhën serbe në sistemin Gjyqësor të Kosovës në bazë të Dialogut të Brukselit, nevoja për legjislacion cilësor dhe përkthim adekuat në gjuhën serbe cilësohet si çështje tejet e rëndësishme. Legjislacioni i Kosovës i përkthyer me cilësi të lartë në gjuhën serbe është një domosdoshmëri për gjyqtarët, prokurorët dhe avokatët të komunitetit Serbë në mënyrë që të funksionojnë në mënyrë efektive brenda sistemit të Kosovës. Sistemi Gjyqësor i Kosovës në praktikë është zhvilluar dhe praktikuar vetëm në një gjuhë përpara Marrëveshjes së Brukselit. Pasi që gjithçka është kthyer në një sistem shumëgjuhësh në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës, për të krijuar një shtet demokratik dhe të qëndrueshëm, duhet patjetër të garantojmë sundimin e ligjit për të gjithë popullin e Kosovës.¹⁸

Problematikë më e thellë për stabilitetin e shtetit të Kosovës, mospërputhja e legjislacionit në gjuhën shqipe dhe serbe mund të ketë gjithashtu ndikim në marrëdhëniet në mes të komuniteteve dhe legjitimiteti i shtetit mund të luhet në sy të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë. Cilësia e dobët e përkthimeve të akteve ligjore në gjuhën serbe de facto krijojnë një zbrazëtim në mes të komunitetit shumicë, i cili mund të konsultojë kornizën ligjore gjithëpërfshirëse dhe me kualitet të lartë gjuhësorë dhe komuniteteve jo-shumicë, të cilat e konsultojnë kornizën ligjore më pak gjithëpërfshirës dhe ndonjëherë të pakuptueshme. Përrjashtimi i komuniteteve nga marrja e cilësisë së njëjtë të shërbimeve dhe siguria ligjore mund të prodhojnë situata që mund të rrisin tensionet, pasi që shteti nuk arrin të ofrojë shërbime kualitative për komunitetet jo-shumicë, apo shkel të drejtat gjuhësore të garantuara. Ky argumentim përdoret nga organizatat jo-qeveritare

¹⁷ Intervista me Gjykatësin Milan Bigović, Shef i Departamentin në Gjykatën e Apelit, korrik, July 2018.

¹⁸ Intervista me Gjykatësin Milan Bigović, Shef i Departamentin në Gjykatën e Apelit, korrik, July 2018.

serbe nga Veriu i Kosovës, siç vërehet nga takimet e zhvilluara dhe organizuara nga ECMI Kosova me këto organizata ndër vite dhe gjithashtu siç është e cekur në raportin PAH (PAH, 2016, f.4-5). Ndonëse gabimet gjuhësore në aktet ligjore mund të cilësohen si gabime të thjeshta, ky fakt bën që mosbesimi i pjesëtarëve të komunitetit Serb për Qeverinë e Kosovës të rritet. Duke e marrë parasysh cilësinë e dobët të përkthimit të legjislacionit në gjuhën serbe, mund të thuhet që Qeveria e Kosovës nuk interesohet dhe angazhohet shumë për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit Serb në Kosovë.

Si përfundim, për shkak të rolit të madhë që gjuha luan në identitetin e një komuniteti, dështimi i shtetit për të ofruar dokumente zyrtare të përkthyer me cilësi të lartë bën që shteti të e humb legjitimitetin e tij në sy të komuniteteve jo-shumicë. Kualiteti i përkthimit shihet si një indikator që përdoret për të matur përkushtimin e shtetit të Kosovës për të ofruar të drejta të barabarta për komunitetin Serb dhe komunitetet tjera jo-shumicë. Ky fakt cilësohet si efekt i shumëfishtë dhe shkelja e të drejtave gjuhësore të komuniteteve tregon që përfaqësuesit e këtyre komuniteteve kanë qasje të kufizuara në të drejtat themelore të njeriut dhe të drejtat e komuniteteve të garantuara në Kosovë. Për më tepër, nëse Qeveria e Kosovës nuk mund të i mbrojë të drejtat gjuhësore të komuniteteve, siç të garantuara me Kushtetutë dhe Ligje, çka mund të pritët tjetër (PAH, 2016). Në fund, nëse ky problem mbetet i pazgjidhur, mesazhi që dërgohet tek populli i Kosovës do të ketë konotacion negativ. Pjesëtarët e komuniteteve nuk ndihen të respektuar nga Qeveria dhe Institucionet e saj, dhe besojnë që ajo nuk ka aftësi apo vullnet të e zgjidhë çështjen në fjalë. Kjo mund të jetë e vërtetë veçanërisht duke e pasur parasysh historinë e cila tregon konfliktin etnik, nga i cili, më së shumti të drejtat gjuhësore ishin të shkelura; kështu që, Qeveria e Kosovës duhet të jetë e vetëdijshme për ndikimin potencial destabilizues që ky problem mund të sjellë.

Për të ngritur nivelin e zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në Kosovë, i cili është mjaft ambicioz, kërkohet angazhim institucional dhe financiar, arsimim, si dhe ngritje të vetëdijes publike. Përmirësimi i gabimeve në përkthim të dokumenteve ligjore në gjuhën serbe, sidoqoftë, duket të jetë relativisht i lehtë menaxhueshëm. Siç e kemi parë në këtë raport, dokumentet ligjore të përkthyer në mënyrë jo të saktë nuk zvogëlojnë vetëm legjitimitetin e shtetit por përcjellin edhe informatë tek populli i Kosovës që Qeveria nuk ka vullnet politik në integrimin e komuniteteve jo-shumicë në nivel të barabartë. Zgjidhja e kësaj çështje do të dërgonte një mesazh pozitiv tek pjesëtarët e komuniteteve jo-shumicë dhe komunitetit Serb në veçanti në lidhje me vullnetin politik të Qeverisë dhe shtetit të Kosovës për të zbatuar plotësisht legjislacionin në fuqi i cili garanton të drejta të barabarta për të gjithë.¹⁹

Një shumicë e madhe e komunitetit Shqiptar konsideron që niveli i kualitetit të legjislacionit të Kosovës i cili mbron dhe promovon të drejtat e njeriut, është më i larti në rajon dhe se çdo marrëveshje tjetër në lidhje me këtë çështje është e panevojshme dhe kanë potencial destabilizues. Prandaj, kemi parë një nxitje politike që Qeveria duhet të marrë hapa dhe vendime të cilët do të adresojnë pakënaqësitë në kornizë ekzistuese për të drejtat e njeriut (Groß, 2015). Megjithatë, integrimi i gjyqësorit në gjuhën serbe në sistemin gjyqësor të Kosovës ka vënë në pah urgjencën e veçantë të adresimit të kësaj çështje. Përpjekjet e avokimit nga shoqëria civile lokale, duke përfshirë "Koalicionin të drejtat e barabarta për të gjithë (ERAC)", e kanë vënë këtë çështje në agjendën e Qeverisë Kosovës. Përfaqësuesit e "Koalicionit të drejtat e barabarta për të gjithë", kanë diskutuar këtë çështje dhe kanë dhënë rekomandime tek Z. Kadri Veseli, Kryetar i Parlamentit, i cili shprehu gadishmërinë dhe mbështetjen e tij për rrugën përpara, duke treguar angazhimin e tij politik për të adresuar dhe trajtuar këtë çështje.

Së fundmi, megjithatë, ka ndodhur një kthesë politike dhe një hap i rëndësishëm në ofrimin e të drejtave të barabarta gjuhësore në lidhje me përkthimin e legjislacionit në gjuhën shqipe dhe serbe me anë të themelimit të Grupit Punues Qeveritarë që ka për qëllim krijimin e Njesisë Qendrore të Përkthimit ("NJQP").²⁰ Ky grup pune së pari do të hartojë një concept document ku do të përshkruhet natyra e punës së Njesisë, dhe me miratimin e Qeverisë, do të hartojë një akt nënligjor për themelimin e Njesisë. Duhet të theksohet se kjo ide është vetëm

¹⁹ Intervista me Gjykatësin Milan Bigović, Shef i Departamentin në Gjykatën e Apelit, korrik 2018.

²⁰ Government of Kosovo Decision 05/12, 3 November 2017

në fazën fillestare, mirëpo tregon që është ndërmarrë një hap i rëndësishëm për adresimin e çështjeve të mospërputhjes në mes të legjislacionit të përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe. Shpresohet që idea e Njesisë Qendrore të Përkthimit të vazhdojë me qëllim që të përmirësohet cilësia e përkthimit nga gjuha shqipe në serbe të ofruara nga institucionet e Qeverisë së Kosovës.

REKOMANDIMET

Rekomandimet e mëposhtme ofrojnë një rrugë të qartë dhe të menaxhueshme për adresimin e mospërputhjeve të përkthimit në gjuhën serbe të legjislacionit të Kosovës.

1. Krijimi i dy (2) komisioneve për të analizuar ligjet ekzistuese dhe për të krijuar një listë të mospërputhjeve dhe pasaktësive në dokumentet ligjore në gjuhën serbe dhe shqipe.

Megjithëse është bërë hulumtimi për mospërputhjet dhe pasaktësitë e përkthimit të dokumenteve ligjore në gjuhën serbe duke i krahasuar verzionet në gjuhën shqipe dhe angleze, nuk është bërë ende një listë e plotë dhe një analizë e cilësisë gjuhësore e të gjitha dokumenteve ligjore që janë në fuqi në Kosovë. Ky është hapi i parë i cili duhet të ndërmerret për trajtimin e kësaj çështje. Rrjedhimisht, duhet të analizohen katër (4) lloje të ligjeve:

- 378 ligje të miratuara nga Kuvendi i Kosovës dhe më pas të botuara në Gazetën Zyrtare;
- Nëntë (9) Instrumentet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut të aplikueshme në Kosovë dhe të përmendura në nenet 22, 53 dhe 58 të Kushtetutës;
- 47 ligjet për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare;
- Aktet nënligjore të nxjerra nga Qeveria dhe të regjistruara në Regjistrin e akteve nënligjore në fuqi.

Është absolutisht e nevojshme që ekspertë gjuhësorë dhe juridikë nga komuniteti Shqiptarë dhe ai Serb të përfshihen në këtë proces, me qëllim që të garantohet pjesëmarrja e të dy (2) komuniteteve. Përndryshe, çdo e gjetur do të bëhet publike dhe do të hudhet në diskutim. Duke pasur parasysh ndërlikimet politike që kanë të bëjnë me pozicionin e Universitetit të Mitrovicës Veriore në fushën akademike në Kosovë, duhet të krijohen dy (2) komisione, të cilat do të sjellin përvojën e tyre ligjore dhe gjuhësore dhe të krahasojnë paralelisht të gjitha dokumentet ligjore. Komisioni i parë do të përbëhet nga përfaqësues të Kuvendit të Kosovës, Zyra e Komisionerit për Gjuhët dhe Departamenti i Ligjorë dhe Departamenti i Gjuhës Shqipe i Universitetit të Prishtinës. Komisioni i dytë do të përbëhet nga përfaqësues të Kuvendit të Kosovës, Zyra e Komisionerit për Gjuhët dhe Departamenti i Ligjorë dhe Departamenti i Gjuhësisë i Universitetit të Mitrovicës Veriore. Këto dy (2) komisione do të udhëheqin punën e përkthyesve të angazhuar. Do të ketë përkthyes për çdo gjuhë të cilët do të shkojnë përgjatë

legjislacionit në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Përkthyesit do të përzgjidhen në bazë të kriterëve të qarta, me fokus të veçantë në përvojën e tyre në përkthimin e dokumenteve ligjore. Secili ligj do të lexohet nga tre (3) përkthyes të ndryshëm. Përkthyesit do të bëjnë një listë të problemeve të terminologjisë që ata gjejnë gjatë leximit të ligjeve. Kjo listë do të i dorëzohet dhe prezantohet të dy (2) komisioneve, të cilat më pas do të vendosin nëse ndryshimi është i nevojshëm.

2. Krijimi i një ekipi ligjor që përbëhet nga Zyra Ligjore e Kuvendit dhe Zyra Ligjore e Kryeministrit të Kosovës për të pregaditur një ligj të ri dhe akt nënligjor për caktimin e mospërputhjeve gjuhësore brenda ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi.

Aktualisht nuk ka asnjë organ institucional të autorizuar për të korigjuar gabimet në legjislacion në mënyrë efikase. Kjo vetëm çka kontribon në forcimin e mosbesimit të komuniteteve se për të adresuar këtë çështje, Qeveria e Kosovës nuk ka vullnet politik. Zyra për Publikimin e Gazetës Zyrtare (ZPGZ) boton të gjitha ligjet që miratohen sipas nenit 80 të Kushtetutës, mirëpo jo edhe legjislacionin dytësorë dhe aktet nënligjore. ZPGZ nuk ka kompetencë të rishikojë cilësinë e gjuhës së legjislacionit në versione të ndryshme gjuhësore. Kjo zyrë vetëm mund të korigjojë gabimet e vogla drejtshkrimore, pas konsultimit me Kuvendin e Kosovës. Çdo mospërputhje duhet të publikohet në atë formë, pasi që Ligji në fjalë është miratuar (OSBE, 2012, f.13).

Për të garantuar zbatimin, Ligji për Përdorimin e Gjuhëve ka krijuar një komision gjuhësorë që ka për qëllim "për të ruajtur, promovuar dhe mbrojtur gjuhët zyrtare dhe statusin e tyre të barabartë në Kosovë".²¹ Zyra e Komisionerit për Gjuhëve e ka në mandatë të saj monitorimin e zbatimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, dhe të adresojë shkeljet që raportohen apo vendos të e bëjë identifikimin e ndonjë shkelje me iniciativë të vet. ZKGJ mund të japë rekomandime dhe vërejtje nëse rekomandimi nuk zbatohet nga intitucioni përkatës, dhe mund të e raportojë situatën e pandryshuar në Kuvend gjatë raportit të saj vjetor.²² Rregulloret e miratuara ndër vite, kanë rritur kompetencat e ZKGJ, e cila tashmë mund të ndërhyjë kur kemi të bëjmë me shkelje të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, ka më shumë staf, hapësirë të zyrës dhe buxhet (OSBE, 2015). Megjithatë, ZKGJ nuk mund të i rregullojë mospërputhjet në legjislacionin e kaluar mirëpo mund të i prezantojë këto keqinterpretime apo mospërputhje. Këto ndryshime mund të bëhen vetëm nga ato organe që e kanë të drejtën ligjore për të i bërë këto ndryshime. Për më tepër, ZKGJ ka kapacitet të kufizuar. Në një intervistë për

²¹ Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (Nr. 02/L-37), Neni 32.1.

²² Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (No. 02/L-37), Art. 36.2.

këtë raport, Z. Sllavisha Mlladenović tregoi se për një efikasitet më të madh në përmbushjen e mandatit të zyrës, kapacitetet njerëzore të ZKGJ-së duhen të dyfishohen. Për momentin, janë disa departamente dhe institucione tjera të cilat kanë objektiva të ndryshme, mirëpo kanë edhe ndikim mbi politikën zyrtare të përdorimit të gjuhëve në Kosovë, gjë që mund të çojë në një konflikt interesi.²³ Ekzistojnë përpjekje të cilat kanë për qëllim hartimin e një ligj të ri që i jep ZKGJ "ndikim më të madh" për ndryshimin e gabimeve dhe mospërputhjeve në ligjet e kaluara.²⁴ Derisa Kuvendi ta kalojë këtë ligj, ndryshimet nuk mund të bëhen pa miratim, prandaj këto gabime do të vazhdojnë të mbeten në dokumentet e Kosovës.

3. Të sigurohet qëndrueshmëria e Njesisë Qendrore të Përkthimit me qëllim të adresimit të mospërputhjeve ndërmjet legjislacionit të përkthyer në gjuhën shqipe dhe serbe

3.1 Të sigurojë që Njësia Qendrore e Përkthimit të themelohet dhe funksionojë në mënyrë efikase dhe të plotë

Qeveria e Kosovës duhet të vazhdojë angazhimin e saj në procesin e krijimit të Njesisë Qendrore të Përkthimit për të siguruar që përkthimi i legjislacionit në gjuhën serbe të bëhet në mënyrë më të shpejtë dhe më efikase dhe pa vonesa. Rëndësia e përkthimit me kualitet të lartë të legjislacionit të Kosovë në gjuhën serbe nuk mund të nënvlerësohet: është e nevojshme të sigurohet një standard i cili harmonizon Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve të vitit 2006. Për më tepër, është e domosdoshme që legjislacioni i Kosovës të jetë konsistent dhe i qartë dhe të tregohet legjitimiteti i tij tek të gjithë qytetarët e Kosovës, veçanërisht tek pjesëtarët e komunitetit Serb. Përderisa Njësia Qendrore e Përkthimit konsiderohet të ketë në përgjegjësi të merr parasysh një numër të madhë konsideratash, ajo rekomandohet të punësojë shtatë (7) deri në dhjetë (10) persona. Stafit duhet të krijojë një strukturë e cila lejon një qasje trefazore për përkthimin më cilësorë dhe efikas të legjislacionit. Së pari, duhet të jetë një fazë fillestare e përkthimit ku dokumentet e gjuhës shqipe përkthehen në gjuhën serbe; e më pas, duhet të pasojë faza e leximit dhe korigjimit, gjatë të cilës duhet të sigurohet lidhja logjike ligjore e dokumenteve në fjalë; në fund, në fazën e editimit, duhen të identifikohen gabimet e mundshme të bëra gjatë përkthimit dhe të perfeksionohet kualiteti gjuhësorë i dokumentit përfundimtarë. Një proces i tillë, do të sigurojë cilësi të lartë gjuhësore të legjislacionit të ardhshëm të përkthyer në gjuhën serbe të hartuar nga Njësia Qendrore e Përkthimit.

²³ Intervistë me Komisionerin për Gjuhët Slaviša Mladenović, tetor, 2018.

²⁴ Intervistë me Komisionerin për Gjuhët Slaviša Mladenović, korrik 2018.

Për shkak të strukturave të pagave të punonjësve të Qeverisë së Kosovës në të cilën ato janë relativisht të kufizuara dhe jo fleksibile, për momentin, mund të jetë e vështirë të punësohen përkthyes të brendshëm profesional sipas Nivelit Profesional 2 dhe Nivelit të Pagës 9. Pas themelimit të Njesisë Qendrore të Përkthimit, Qeveria duhet të marrë në konsideratë punësimin e përkthyesve brenda Njesisë sipas Nivelit Profesional 3 dhe nivelit përkatës të pagave më të larta. Për më tepër, NJQP-së duhet të i ipet mundësia të kontraktojë përkthyes të jashtëm profesional kur është e nevojshme, me qëllim që të sigurohet një cilësi e mjaftueshme e legjislacionit të përkthyer në gjuhën serbe.

3.2 Krijimi i një fjalori për zbatimin e kushteve të standardizuara si në nivel lokal ashtu edhe në atë qendror

Njësia Qendrore e Përkthimit, pas krijimit, duhet të fillojë menjëherë të bashkëpunojë me Qeverinë e Kosovës në mënyrë që kjo e fundit të zhvillojë një Fjalor Ligjorë Dytjuhësor për Kosovën si një mekanizëm i cili do të sigurojë zgjidhje të qëndrueshme për zgjidhjen e problemeve të mospërputhjeve gjuhësore të legjislacionit në të ardhmen. Fjalori Ligjorë Dytjuhësor për Kosovën do të përpilohet dhe publikohet nën mbikqyrjen e Zyrës së Komisionerit të Gjuhëve në mënyrë që të sigurohet që të ketë qëndrueshmëri gjuhësore, duke ndjekur modelin e përdorur në Zvicërr.²⁵ Kontributi i dhënë nga Njësia Qendrore e Përkthimit do të sigurojë që Fjalori të ketë një standard të lartë dhe të shmang konfuzionet apo mospajtimet në lidhje me definicionet e përdorura. Fjalori do të bëjë një listë të terminologjisë ligjore të Kosovës dhe do të ofrojë përkthim fiks për termet ligjore në gjuhën shqipe dhe serbe. Kjo terminologji standard do të përdoret nga të gjitha institucionet e Kosovës, siç të obliguara me ligj. Struktura e Fjalorit do të krijohet sipas fushave ligjore specifike dhe shpjegimi më i detajuar do të ipet për ato raste të cilat cilësohen të kenë terminologji problematike. Fjalori duhet të miratohet nga Kuvendi si fjalor zyrtar për përkthimin e ligjeve. Përkthyesit në institucionet qeveritare dhe Njësinë Qendrore të Përkthimit do të ndjekin trajnime se si duhet të e përdorin fjalorin.

²⁵ Fjalori Trigjuhësorë Zvicrran I Ligjit do të përdoret si shembull, dhe disa fqe me shembuj mund të l gjeni këtu: https://docs.wixstatic.com/ugd/aed330_e593d46518904cb6b1453b8eb1fbbc61.pdf.

REFERENCAT

Demaj, U. & Vandenbroucke M. (2016). Peizazhet e Kosovës pas luftës në Prishtinë: Mospërputhjet ndërmjet politikës gjuhësore dhe realitetit urban.

Groß, L. (2015). Udhëtimi nga Global në Lokal: promovimi i normave, kontestimi dhe lokalizimi në Kosovën e pasluftës, Gazeta e Marrëdhënieve Ndërkombëtare dhe Zhvillimit.

KCSF (2018). "Në ndërtim" - Platforma online për konsultime publike gjatë vitit 2017. https://www.kcsfoundation.org/wp-content/uploads/2018/06/03_04_2018_9878891_Online_Platform_during_2017_KCSF.pdf

Kostovicova, D. (2005). Kosova: Politika e Identitetit dhe Hapësirës (London: Routledge).

Zyra e Komisionerit për Gjuhët (ZKGJ) / Zyra e Kryeministrit (2015). Monitorimi dhe Vlerësimi i të Drejtave Gjuhësore në Kosovë. Oline në: http://www.komisioneri-ks.org/repository/docs/Anlisht_Finale_160315.pdf

OSBE (2012). Legjislacioni shumëgjuhësh në Kosovë dhe sfidat e saj. <https://www.osce.org/kosovo/87704?download=true>

OSBE (2015). Pajtueshmëria e Gjuhëve në Kosovë. <https://www.osce.org/kosovo/120010?download=true>

OSBE (2018). Legjislacioni dygjuhësh në Kosovë.

<https://www.osce.org/mission-in-kosovo/396836?download=true>

Petković, J.L. (2014). Pravo na jezik. Vesti online në <https://vesti-online.com/Vesti/Srbija/431776/Pravo-na-jezik-1-Srbi-ugrozeni-i-u-prevodu> ;

<https://vesti-online.com/Vesti/Srbija/432118/Pravo-na-jezik-2-Tranziranje-osnovnih-prava>

Petković, J.L. (2015). Kosova është humbur në përkthim. Vesti.

<https://vesti-online.com/Vesti/Tema-dana/469591/Kosovo-izgubljeno-u-prevodu-1-Albancima-globa-Srbima-zatvor>;

<https://vesti-online.com/Vesti/Tema-dana/469664/Kosovo-izgubljeno-u-prevodu-2-Priuceni-prevodioci>;

<https://vesti-online.com/Vesti/Tema-dana/469906/Kosovo-izgubljeno-u-prevodu-3-Pravo-na-zalbu-samo-tuziocu>;

<https://vesti-online.com/Vesti/Tema-dana/470338/Kosovo-izgubljeno-u>

[prevodu-4-Nezadovoljni-i-Srbi-i-Albanci Petković, J.L. \(2015\). Kosovo izgubljeno u prevodu. Vesti.](#)

[https://vesti-online.com/Vesti/Tema-dana/469591/Kosovo-izgubljeno-u-
prevodu-1-Albancima-globa-Srbima-zatvor;](https://vesti-online.com/Vesti/Tema-dana/469591/Kosovo-izgubljeno-u-
prevodu-1-Albancima-globa-Srbima-zatvor;)

[https://vesti-online.com/Vesti/Tema-dana/469664/Kosovo-izgubljeno-u-
prevodu-2-Priuceni-prevodioci;](https://vesti-online.com/Vesti/Tema-dana/469664/Kosovo-izgubljeno-u-
prevodu-2-Priuceni-prevodioci;)

[https://vesti-online.com/Vesti/Tema-dana/469906/Kosovo-izgubljeno-u-
prevodu-3-Pravo-na-zalbu-samo-tuziocu;](https://vesti-online.com/Vesti/Tema-dana/469906/Kosovo-izgubljeno-u-
prevodu-3-Pravo-na-zalbu-samo-tuziocu;)

[https://vesti-online.com/Vesti/Tema-dana/470338/Kosovo-izgubljeno-u-
prevodu-4-Nezadovoljni-i-Srbi-i-Albanci](https://vesti-online.com/Vesti/Tema-dana/470338/Kosovo-izgubljeno-u-
prevodu-4-Nezadovoljni-i-Srbi-i-Albanci)

Platforma për Analiza dhe Hulumtime (PAH) (2016). Cilësia e përkthimit të ligjeve të Kosovës në gjuhën serbe. Në dispozicion në <http://www.ngoaktiv.org/uploads/files/Policy%20Brief%20-%20Quality%20of%20Translation%20of%20Kosovo%20Laws%20into%20Serbian%20Language.pdf>

Raportuesi Special i Kombeve të Bashkuara për Çështjet e Pakicave (2017). Të Drejtat Gjuhësore të Pakicave Gjuhësore: Një Udhëzues Praktik për Zbatimin. Në dispozicion në internet në https://www.ohchr.org/Documents/Issues/Minorities/SR/LanguageRightsLinguisticMinorities_EN.pdf

ERAC

EQUAL RIGHTS FOR ALL COALITION



 European
Union
Kosovo